

KONCESIONE / PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

KOMISIONI I DHËNIES SE KONCESIONIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës	Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Suha e Sipërme”
Forma e kontratës	B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)
Burimi i financimit	Shoqëri tregtare private / Kapital privat
Vlera e parashikuar e projektit:	684,525,663 Leke (pa TVSH)
Kohëzgjatja e kontratës :	35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 35 date 04.9.2017

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara: Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Favina” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. – Kualifikohet me 95 pike, me këto karakteristika kryesore te ofertës:

Fuqia e instaluar e percaktuar me prurjen llogaritese	5,423 kW
Prodhimi i energjise elektrike	21,089,286 kWh
Vlera e “Fee koncesionare”	2% (421,786 kWh)
Koha e zbatimit te punimeve	24 muaj
Kosto per njesi e makinerive dhe Pajisjeve per kW fuqi te instaluar	41,241 leke/kW

* * *

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Z. Viktor Qylafi, Përfaqësues me Prokure, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Favina” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. me adrese: Rruga “Ismail Qemali”, Lagjja nr. 7, Nr. 13, Korçë, se oferta e paraqitur më datë 29 Shtator 2017, për marrjen me koncesion te hidrocentralit “Suha e Sipërme”, është pranuar.

Afati i negociimit te Kontratës tuaj do te jete brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit te fituesit.

Bashkimi Përkohshëm i Shoqërive “Favina” sh.p.k. dhe “Gener 2” sh.p.k. kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat Standarte të Procedurës Konkurruese, në vlerën e 10% të Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.

Krijimin e Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri koncesionare” dhe me objekt “Objektin e kontratës së koncesionit”, me të cilin Autoriteti Kontraktues do të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit, me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.

Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.11.2017

Ankesa: Nuk ka